

## AKT THEMELIMI

**I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar  
“Ballkan Cosmetics Distribution “ shpk**

Ne Tirane, sot me date 19 Qershor 2024, ne cilesine e “ortakeve themelues “:

**Z.Ergys Mezini**, atesia Refik , i dtl 02.08.1989, Tirane, Shqiperi dhe banues ne Rruga Zonja Curre, Nr. Ap2 Zona Kadastrale 8160 Shqiperi, shtetas shqipetar, madhor, me zotesi juridike per te vepruar, mbajtes i kartes me nr. I90802073J.

**Z.Sezayir Arslan**, atesia Cezayir , i dtl 02.03.1995, Diyarbakir, Turqi dhe banues ne Berxulle Domje, Bashkia Vore, Nr pasurie 315/63, Shqiperi, shtetas Turk, madhor, me zotesi juridike per te vepruar, mbajtes i pashaportes me nr. U20105823

Te cilet ne cilesine e “ortakeve themelues “, me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, hartuan kete akt themelimi per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “ BALLKAN COSMETICS DISTRIBUTION“ shpk mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare “ te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

### KREU I

Neni 1  
Krijimi

Shoqeria “ BALLKAN COSMETICS DISTRIBUTION“ shpk, eshte person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”). **Emri tregtar i shoqerise “ Ballkan Cosmetics Distribution “**

Neni 2  
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “ BALLKAN COSMETICS DISTRIBUTION“ shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaket e shoqerise”, te cilet nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributet e ortakeve përbeyne kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gjëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që kane dhënë në kapital.

Neni 3  
Selia

Shoqeria e ka seline kryesore ne Rruga Elbasanit, Tirane, Zona Kadastrale 8160, Nr. Pasurie 4/719, Shqiperi. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikës se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Shoqerise.



Neni 4  
Objekti i veprimtarise

Distribucion i Produkteve Kozmetike dhe estetike, Import-Eksport, Tregtim me shumice dhe me pakic i produkteve te ndryshme te kujdesit personal dhe artikujve te tjere te perdonimit dermo estetik. Tregtia e pajisjeve dhe aksesoreve te ndryshem te perdonshem per kurimin esteik personal etj.

Neni 5  
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

**KREU II  
KAPITALI**

Neni 6  
Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 lekë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe do te shlyhet apo te hapen llogarite bankare te shoqerise teresisht ne te holla nga "ortaket e shoqerise".

Z.Ergys Mezini eshte zoterues i nje kuote me vlore 50.000 leke, e cila perfaqeson 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Z.Sezayir Arslan eshte zoterues i nje kuote me vlore 50.000 leke, e cila perfaqeson 50 % te kapitalit themeltar te shoqerise

Kontributi i ortakut mund te jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) Ortaku pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7  
Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund te zvogëlohet me vendim të Asamblese se Ortakeve te shoqerise në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga Administratori, në përpjekje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

## Neni 8

### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## **KREU II**

### **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

## Neni 9

### Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakut eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e Ortakut, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e Administratoriëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërbllimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj Administratoriëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilis nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet përiorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10  
Administrimi

Administratoret e shoqerise jane:

**Z.Ergys Mezini** i identifikuar me nr ID: I90802073J

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte riperteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asambleja e Ortakut te shoqerise. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

Neni 11  
Kompetencat

Administratori ka tё drejtё e detyrohet tё:

- a) kryejё tё gjitha veprimet e administrimit tё zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare tё shoqёrisë, duke zbatuar politikat tregtare, tё vendosura nga Asambleja e Ortakut;
  - b) pёrfaqёsjojё shoqёrinё tregtare;
  - c) kujdeset pёr mbajtjen e saktё e tё rregullt tё dokumenteve dhe tё librave kontabёl tё shoqёrisë;
  - ç) pёrgatisё dhe nёnshkruajё bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisё sё veprimtarisë dhe, sё bashku me propozimet pёr shpёrndarjen e fitimeve, i paraqesin kёto dokumente pёrpara Asambleja e Ortakut pёr miratim;
  - d) krijojё njё sistem paralajmёrimi nё kohёn e duhur pёr rr Ethanat, qё kёrcenojnё mbarёvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencёn e shoqёrisë;
  - dh) kryejё regjistrimet dhe dёrgojё tё dhёnat e detyrueshme tё shoqёrisë, siç parashikohet nё ligjin pёr Qendrёn Kombёtare tё Regjistrimit;
  - e) raportojё pёrpara asamblesё sё pёrgjithshme nё lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve tё posаçme me rёndesi tё veçantё pёr veprimtarinё e shoqёrisë tregtare;
- Administratori eshtё i detyruar tё thёrrasё mbledhjen e Asambleja e Ortakut edhe ne rastet kur :
- sipas bilancit vjetor apo raporteve tё ndёrmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qё aktivet e shoqёrisë nuk i mbulojnё detyrimet e kёrkueshme brenda 3 muajve nё vazhdim dhe kur shoqёria, brenda 2 viteve tё para pas regjistrimit tё tij, propozon tё blejё nga njё ortak pasuri, qё kanё vlerë mё tё lartё se 5 pёr qind tё aseteve tё shoqёrisë, qё rezulton nё pasqyrat e fundit financiare tё certifikuara,
- Administratorii ka tё drejte tё kryeje tё gjitha veprimet e administrimit tё zakonshem e tё jashtezakonshem. Administratorii pёrfaqёson Shoqёrinё pёrpara tё gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo tё huaj, autoritetete shtetёre Shqiptare apo tё huaja, Bankave te te gjitha niveleve, zyrate te tatim taksave, autoritetete doganore, pёrfshi kёtu edhe autoritetet gjyqёsore tё gjitha shkallevet. Administratorii angazhon shoqёrinё nё marrёdhёniet me tё tretёt nёpёrmjet akteve qё janё nё pёrputhje me objektin e tij.
- Shoqёria nuk merr pёrsipёr pasojat ndaj tё tretёve kur ajo provon se tё tretёt e dinin qё akti i Administratoreve e kalonte objektin e shoqёrisë ose kur tё tretёt nuk mund ta injoronin kёtё akt nё rr Ethanat e dhёna, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshtё provё e mjaftueshme.

Neni 12

Pergjegjesite

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakut që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen Administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, Administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arrijen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyras së tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administratori, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.



### Neni 13

#### Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

### Neni 14

#### Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Asambleja e Ortakut, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asambleja e Ortakut vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

### Neni 15

#### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.


### Neni 16

#### Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise "BALLKAN COSMETICS DISTRIBUTION" shpk, u redaktua me vullnetin te lire e te plete te "ortakeve themelues", ne 2 ekzemplare me vlera te njejtta juridike ne gjuhen shqipe.

### **ORTAKET E SHOQERISE**

**Z.Ergys Mezini**



**Z.Sezayir Arslan**

